



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 103 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 24 / 10 / 2022

VENDIM
Nr.26, date 24 /10/2022

PËR

PROJEKTIN E ZBATIMIT PER RIPARIME NE DIGEN E LIBOFSHES, FIER

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 24.10.2022 mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Fier për të shqyrtuar projektin e zbatimit në lidhje me disa punime riparimi në digën e Libofshes që administrohet nga Bashkia Fier. Sipas rregjistrimit të KKDM, Diga e Libofshes ka një lartësi prej 19.4 m, gjatësi të kreshtes së digës prej 270 m dhe volum të trupit të digës prej 122 000 m³. Bazuar në Nenin 27 të VKM se mesiperme si dhe në faktin që punimet e parashikuara konsistojnë në disa riparime të kesaj dige, Bashkia Fier nuk kërkon miratim të projektit

Në mbledhje ishin prezent përfaqësues të Bashkisë Fier dhe të firmës konsulente EBS. Përfaqësuesi i firmës Konsulente, informoi për masat e parashikuara në projekt në lidhje me riparimin e kesaj dige. Në keto masa përfshihet edhe riparimi i shkarkuesit si dhe riparimi i një rreshqitje të vogël sipërfaqesore në anën e poshtme të trupit të digës. Sipas projektuesit dhe bazuar në llogaritjet e qendrueshmerisë së digës të kryer prej ekipit të tyre, rezultojnë se diga është e qendrueshme statikisht. Njekohësisht, bazuar në një analizë të plote të situatës aktuale të shqyrtuar është e nevojshme riparimi i kesaj zone në trupin e digës si dhe disa punime të tjera riparuese në sistemin e shkarkimit dhe të marrjes së ujit

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

1. Të pranohet kërkesën e Bashkisë Fier për të vijuar punimet për riparimin e digës së Libofshes duke u bazuar në nenin 27 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004
2. Ti kërkojë Bashkisë Fier:
 - Projekti të parashikoj edhe instalimin e një sistemi të monitorimit gjeodezik me të paktën 7 monumente gjeodezike betoni në trupin e digës dhe në zonën përreth digës duke përfshirë edhe matjet dhe leximin 0 në pikat e këtij sistemi
 - Projekti të parashikoj ndertimin e të paktën 2 kapërderdhesave në anën e poshtme të trupit të digës për matjen dhe monitorimin e filtrimeve pas punimeve të riparimit
 - Të informoj KKDM për fillimin e punimeve dhe caktimin e Mbikqyresit të punimeve dhe Kolaudatorit të punimeve sipas kërkesave të VKM së mesiperme, neni 20 dhe neni 21;
 - Ti parashikoj që gjatë zbatimit të punimeve, kontraktori duhet të ketë një ekspert gjeolog I cili do të jetë përgjegjës për testimin dhe raportin gjeologjik - inxhinierik në lidhje me rezultatet e testimit të materialeve të ndertimit, materialit mbushës në trupin e digës si dhe karakteristikat e materialit mbushës ekzistues dhe materialit të ri që do të përdoret në trupin e digës;
 - Të dorëzohet pranë KKDM projekti i zbatimit sipas faktit të punimeve të shoqëruar me dokumentacionin teknik të plote të zbatimit të punimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe aktin e kolaudimit të punimeve
 - Bazuar në rezultatet e këtij projekti në lidhje me hartën e permbytjeve dhe banoret që janë në rrezik në zonën urbane poshtë digës, të përgatitet dhe të dorëzohet për shqyrtim pranë KKDM Planin e Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile të shoqëruar me hartën e permbytjes dhe skenaret e rrezikut dhe të dhënies së alarmit. Bashkia Fier duhet të parashikojë sa më shpejt të jetë e mundur hartimin e një projekti për instalimin e një sistemi alarmi në digë dhe në zonën urbane poshtë saj;
 - Të përgatitet dhe të dorëzohet pranë KKDM rregulloren e shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digës sipas Nenit 29 të VKM së mesiperme dhe Vendimit të KKDM Nr.3, datë 09.10.2020 "Udhëzues i përgjithshëm për hartimin e rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të digave"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Brenda vitit 2022 te dorezohet pranë KKDM nje Raport në lidhje me Vlerësimin e aseteve të digave te Libofshes, Turbull, Lalarit, dhe Petoves që administrohen nga Bashkia Fier duke përfshire edhe vlerën e këtyre aseteve deri në fund të vitit 2021.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM per ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

